



Instituti Ndërkombëtar
i Mendimit Islam (IIIT)



Instituti Shqiptar i Mendimit
dhe i Qytetërimit Islam (AIITC)



Konferencë Ndërkombëtare:

MËSIMI PËRGJATË JETËS NË EPOKËN DIGJITALE

3-4 tetor 2020 | Vlorë, Shqipëri

DATA TË RËNDËSISHME

- ✓ Dorëzimi i abstraktit deri më: **25 korrik 2020**
- ✓ Miratimi për pranimin e abstraktit: **01 gusht 2020**
- ✓ Dorëzimi i punimit të plotë: **10 shtator 2020**

Dërgoni abstraktin tuaj në adresën: info@iETT.al

Në bashkëpunim me:



Konferencë Ndërkombëtare MËSIMI PËRGJATË JETËS NË EPOKËN DIGJITALE

3-4 tetor 2020 | Vlorë, Shqipëri



THIRRJE E HAPUR PËR KUMTESA

PARAQITJE

Në këto fillime të shekullit XXI, jemi dëshmitarë të zhvillimit të mësimit gjatë gjithë jetës, si strategji për të siguruar integrimin shoqëror, punësimin dhe zhvillimin e vazhdueshëm personal. Konceptimet e mëhershme të nocionit nga dekadat e fundit të shekullit XX, tashmë kanë marrë formë në një numër dokumentesh mbarëbotërore dhe europiane, në të cilat kërkohen shtysa për mundësimin e mësimit dhe arsimit përgjatë jetës së individit. Ndërsa nismat drejt rinovimit të agjendave të mësimit përgjatë gjithë jetës po shkojnë duke u përmbledhur, bota po hyn në revolucionin e katërt industrial, i karakterizuar nga digjitalizimi dhe prania e teknologjisë në çdo segment të jetës njerëzore.

Ndër sfidat në rritje të epokës digjitale, arsimit dhe mësimi po përballen me shtysa për të rishqyrtuar rolet e tyre, si në jetën e individit, ashtu edhe në atë shoqërore. Këndvështruar nga perspektiva e shoqërive, pritet që arsimit të na japë zgjidhjet e duhura ndaj pasigurisë në rritje, konflikteve, çështjeve mjedisore e shëndetësore, njëkohësisht të përshtatet ndaj zhvillimit teknologjik dhe ekonomik. Njohuritë dhe aftësitë që një individ i fiton përmes arsimit zyrtar, janë të pamjaftueshme për punë të suksesshme në këtë botë në ndryshim të vazhdueshëm.

Mënyra se si edukimi i jep drejtim nevojës për zhvillim të vazhdueshëm individual dhe transformim shoqëror, mundësohet përmes mjeteve digjitale (multimedias dhe telefonisë celulare, aplikacioneve, platformave në internet, mediave sociale, librave dhe përmbajtjeve mësimore të digjitalizuara, duke përmendur vetëm disa). Siç tregon kriza aktuale e COVID-19, burimet e digjitalizuara të mësimit dhe platformat në internet luajnë rol jetik në ruajtjen e sigurisë dhe vazhdimësisë së proceseve të të nxënësve. Sidoqoftë, efektet kryesore të teknologjive digjitale në arsim dhe mësim janë të shumanshme, prandaj duhet të analizohen nga afër. Epoka digjitale, duke ofruar një mori mundësish për të përmirësuar ofertën arsimore, në të njëjtën kohë, synon ndryshimin e qasjeve dhe praktikave të njohura. Kësisoj, synon njohuri dhe aftësi të reja, ndryshon natyrën e ndërveprimit arsimor dhe marrëdhënieve midis mësuesit dhe nxënësit.

Një nga fushat të cilave padyshim që duhet t'u drejtohet mësimi përgjatë jetës, është ai i edukimit fetar, me një larmi përmbajtjesh mësimore, mënyrash dhe formash. Me teknologjitë digjitale bëhet më e lehtë arritja në grupe të caktuara të nxënësve (p.sh.: rinia, të punësuarit dhe ata që ndodhen larg). Siç tregon "Kriza e Koronës", teknologjitë digjitale mund të lehtësojnë edhe praktikën e rregullta fetare të komunitetit, siç janë hytbetet e së premtes ose ligjëratat e Ramazanit. Gjithsesi, duket se nganjëherë, brenda bashkësive dhe organizatave fetare, mësimi gjatë gjithë jetës nuk praktikohet siç duhet dhe mundësitë e teknologjive digjitale nuk përdoren plotësisht.



OBJEKTIVAT

Përkundër një sfondi të tillë, kjo konferencë synon të arrijë të një kuptim më i mirë i vlerës së mësimi përgjatë jetës në epokën digjitale. Duke e hapur fushën për diskutime, analiza, hulumtime dhe shkëmbim të praktikave të mira, bazuar në përvojat lokale, konferenca përpaket:

- Të nxisë zhvillimin e mësimi përgjatë gjithë jetës, si një mënyrë për t'u bërë ballë ndryshimeve të vazhdueshme.
- Të vlerësojë mënyrat e shfrytëzimit më të mirë të potencialeve të teknologjive digjitale në mësimin përgjatë jetës, duke e vënë theksin veçanërisht tek arsimi islam.

Konferenca synon të sjellë së bashku aktorë nga fusha dhe shtresa të ndryshme, institucione kërkimore-shkencore, institucione shtetërore, OJQ, organizatorë dhe ofrues të arsimit, institucione të bashkësive fetare islame, udhëheqës të komunitetit, mësues dhe predikues.

Pesë pikat kyçe që do të trajtohen në konferencë, janë:

1. Cilave nevoja specifike mundet t'u drejtohet mësimi përgjatë jetës në shoqëritë tona?
2. Çfarë dimë mbi mundësitë që shpalos epoka digjitale për mësimin përgjatë jetës?
3. Cilat do të ishin efektet anësore të pashmangshme të digjitalizimit në mësimin përgjatë jetës, që duhen par shikuar dhe trajtuar me kohë?
4. Me cilat mjete mund të mbështesë teknologjia e informacionit zhvillimin e mëtejshëm të mësimi përgjatë jetës në vendet tona?
5. Si mund të formësohet mësimi islam përgjatë jetës në epokën digjitale dhe cilat janë mundësitë për institucionet dhe organizatat e arsimit islam?

GRUPET TEMATIKE

Prezantimet e konferencës do të organizohen në pesë grupe tematike, që synojnë të mbulojnë çështje të gjera dhe të veçanta të mësimi përgjatë jetës në epokën digjitale. Temat e dhëna në secilin grup tematik nuk kanë për qëllim të kufizojnë prezantimet, por shërbejnë për të treguar hapësirën e pritshme të diskutimeve. Studimet e rasteve të përvojave dixhitale aktuale në shkolla, kolegje, xhamia, komunitete, familje dhe OJQ, para dhe gjatë pandemisë do t'i kushtohet vëmendje e veçantë.

Grupi I - Çështjet etike të mësimi përgjatë gjithë jetës në epokën digjitale.

- Njeriu dhe teknologjia. Aspekte etike dhe teknike.
- Mësimi gjatë gjithë jetës midis modeleve tradicionale dhe sfidave të digjitalizimit.
- Arsimimi profesional dhe edukimi fetar. Pikëlidhje dhe dallime.
- Sfidat dhe mënyrat e kapërcimit të vështirësive teknologjike në arsimin e vazhdueshëm në epokën digjitale.

Grupi II - Të mësuarit përgjatë jetës, si strategji për përballimin e ndryshimeve shoqërore.


- Të mësuarit gjatë jetës në shërbim të zhvillimit personal dhe profesional.
- Ndryshimet në shoqëritë dhe arsimi përballë digjitalizimit.
- Kapacitetet e mësimi gjatë gjithë jetës për të shtuar potencialet e digjitalizimit, përmes të mësuarit zyrtar, formal dhe joformal.
- Migrimet, situatat pandemike, krizat ekonomike dhe mësimi përgjatë gjithë jetës.
- Roli i mësimi islam përgjatë gjithë jetës në përballjen më të mirë ndaj ndryshimeve.

Grupi III - Mundësitë dhe sfidat e epokës digjitale për mësimin përgjatë gjithë jetës.

- Niveli i digjitalizimit të shoqërive tona dhe burimet e nevojshme teknike.
- Kapacitetet e organizatave dhe institucioneve për zbatimin e digjitalizimit në mësimin përgjatë gjithë jetës.
- Programet e aftësimit të mësimdhënësve mbi përdorimin e mjeteve digjitale në arsim.
- Mundësimi i burimeve të mësimi digjital për grupet e brishta dhe të marginalizuara.
- Teknologjitë digjitale dhe migrimi (mësimi digjital i të moshuarve për të mbajtur komunikimin me familjen e tyre në vendet e largëta, mjete digjitale për të ndihmuar refugjatët dhe emigrantët në rrugët e tyre).

MËSIMI PËRGJATË JETËS NË EPOKËN DIGJITALE

3-4 tetor 2020 | Vlorë, Shqipëri



Grupi IV - Perspektivat lokale të mësimit përgjatë jetës

- Politikat dhe praktikat ekzistuese në mësimin përgjatë gjithë jetës (strategji, legjislacion, agjendë etj.)
- Aktorët e mësimit përgjatë jetës në epokën digjitale dhe roli i tyre në këtë proces: Mësuesit, ligjëruesit, imamët, predikuesit, aktivistët e shoqërisë civile etj.
- Roli i institucioneve shtetërore dhe fetare në promovimin e të mësuarit përgjatë gjithë jetës. Vetëdijesimi i tyre mbi rëndësinë e tij.
- Ndikimi dhe përfitimet e mësimit përgjatë gjithë jetës për grupet e marginalizuara, si të mbijetuarit e masakrave dhe gjenocidit, njerëzit me aftësi të kufizuara, refugjatët, grupet e pakicave etj.

Grupi V - Organizatat dhe institucionet islame, si ofruese të mësimit përgjatë jetës në epokën digjitale

- Tematikat dhe programet e arsimit islam, në kuadër të mësimit përgjatë gjithë jetës.
- Mundësitë e digjitalizimit të përmbajtjeve ekzistuese të arsimit bazë islam.
- Platforma e mësimit on-line për grupe të veçanta.
- Aftësimi digjital për ofruesit e arsimit.
- Vlerësimi i nevojave arsimore të grupeve të ndryshme që mund të trajtohen nga teknologjitë digjitale.

DATA TË RËNDËSISHME

- | | |
|--|-------------------------|
| • Afati i fundit për dorëzimin e abstraktit: | 25 korrik 2020 |
| • Miratimi për pranimin e abstraktit: | 01 gusht 2020 |
| • Dorëzimi i punimit të plotë: | 10 shtator 2020 |
| • Datat e konferencës: | 03-04 tetor 2020 |

UDHËZIME PËR AUTORËT:

- Punimet që do të prezantohen në konferencë, do të vlerësohen nga Këshilli Shkencor i Konferencës.
- Kumtesat duhet të trajtojnë një nga temat e rekomanduara, ose të kenë lidhje të drejtpërdrejtë me temën kryesore të konferencës.
- Kumtesa duhet të jetë 6 mijë deri në 10 mijë fjalë.
- Udhëtimi dhe akomodimi gjatë dy ditëve të konferencës, do të mbulohen nga organizatorët për autorët e përzgjedhur që marrin pjesë në Konferencë (një person për një prezantim të përzgjedhur).
- Dërgoni abstraktin tuaj në adresën: **info@iETT.al**

KËSHILLI SHKENCOR DHE ORGANIZATOR:

- **Dr. Ardian Muhaj**, Drejtor i AIITC, Tiranë, AL
- **Prof. Dr. Ahmet Alibasic**, Drejtor i CAS, Sarajevë, BiH
- **Prof. Ass. Dr. Ramiz Zekaj**, Drejtor i IETT, Tiranë, AL
- **Assoc. Prof. Reis Mulita**, PhD, Zv. Rektor i CIT, Tiranë, AL
- **Prof. Ass. Dr. Fahrush Rexhepi**, Dekan FSI, Prishtinë, KS
- **Prof. Omer Kajoshaj**, Drejtor i Horizonti, Podgoricë, MZ
- **Mr. Ali Bardhi**, Kryeimam i Ulqinit, MZ
- **Anisa Hykaj**, Koordinatore e Konferencës, Tiranë, AL
- **Resilda Muça**, Sekretare IETT, Tiranë, AL
- **Asmir Aljić**, Sekretar i CAS, Sarajevë, BiH
- **Resul Alić**, Asistent sekretar i CAS, Sarajevë, BiH

Contacts:

Anisa Hykaj | +355 69 25 18 026 | anisahykaj@hotmail.com

Resilda Muça | +355 67 605 80 44 | info@iETT.al

Asmir Aljić | +387 61 489 622 | cns.sarajevo@gmail.com

Resul Alić | +387 61 434 113 | office@cns.ba